

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

në mes

KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

dhe

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT

për

Bashkëpunimin lidhur me verifikimin dhe përzgjedhjen e gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (më tutje KGJK) dhe Agjencia Kundër Korrupsionit (më tutje Agjencia) kanë për qëllim që kushtet e mëposhtme të rregullojnë përpjekjet e tyre të përbashkëta lidhur me verifikimin të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës.

A. Pjesëmarrësit:

KGJK-ja dhe Agjencia janë pjesëmarrës në këtë marrëveshje për bashkëpunim në mes tyre dhe në këtë cilësi kanë nënshkruar këtë Memorandum të Mirëkuptimit (më tutje MiM).

Ky MiM është i bazuar dhe zëvendëson MiM e më hershëm të bërë në mes të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (me tutje KPGJP) dhe Agjencisë, ku KGJK e merr rolin e KPGJP-së lidhur procesin e rekrutimit dhe përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Qëllimi dhe Fusha:

1. KGJK ka përgjegjësinë për të rekrutuar dhe përzgjedhur gjykatësit (dhe prokurorët në baza të përkohshme) sipas Nenit 108 paragrafi 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Rregullores së UNMIK-ut. 2005/52.
2. MiM përcakton përgjegjësitë e parapara për secilin pjesëmarrës lidhur me bashkëpunimin në mes tyre.

B. Përgjegjësitë e KGJK-së:

1. Gjatë hetimeve të së kaluarës KGJK-ja do të dërgoj kërkesa tek AKK-ja me synim për të marrë informata lidhur me *pasurinë e kandidatëve*, kryesisht për ti krahasuar informatat e siguruar nga kandidatët me dosjet e shënimeve të AKK-së.

01-3992/10
16.12.2010

2. Qasje në të dhënat personale të kandidatëve mund të kenë vetëm anëtarët e KGJK-së dhe stafi i KGJK-së i autorizuar nga Kryesuesi i KGJK-së, me qëllim të arritjes së objektivave të KGJK-së.
3. KGJK-ja tashmë do të ndërmarrë masa të nevojshme për të garantuar nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale që së paku është i barasvlershëm me atë që rezulton nga zbatimi i parimeve të Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve Lidhur me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale të datës 28 janar 1981 dhe amendamenteve te saja.

C. Përgjegjësitë e Agjencisë:

1. Me qëllim të kryerjes së detyrave të parapara me Ligjin Kundër Korrupsionit ishte themeluar një organ i njohur me emrin Agjencia Kundër Korrupsionit si një prej masave brenda strategjisë për luftimin e korrupsionit. Siç është paraparë me Kreun 5 të Ligjit Kundër Korrupsionit, qëllimi kryesor i Agjencisë është mbikëqyrja e pasurisë së zyrtarëve të lartë dhe zhvillimi i hetimeve administrative të rasteve të pohuara të korrupsionit, siç është paraparë me Kreun 2, Neni 14 të këtij Ligji, me ç'rast nuk do të inicioheshin procedura penale.
2. Agjencia bashkëpunon me të gjitha autoritetet vendore dhe ndërkombëtare të ngarkuara për zbatimin e ligjit gjatë procedurave hetimore që kryhen nga këto autoritete, siç është paraparë me Kreun 2, Neni 23 të Ligjit Kundër Korrupsionit.
3. Agjencia do të ofroj informatat e kërkuara nga KGJK-ja në pajtueshmëri me rregullat dhe procedurat e brendshme të Agjencisë. KGJK-ja do të kërkojë informata nga të dhënat e Agjencisë të përshkruara në Kreun 6, Neni 46, paragrafi 46.2, pikat a), b) dhe e) të Ligjit Kundër Korrupsionit.

D. Ndryshimet dhe hyrja në fuqi:

1. Ky MiM mund të ndryshohet me pajtimin e Pjesëmarrësve.
2. Ky MiM hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit nga ana e të dy pjesëmarrësve.

Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës:

.....
Enver Peci

Kryesues i KGJK-së

Për Agjencinë Kundër Korrupsionit:

.....
Hasan Preteni

Drejtor i AKK-së

06.12.2010

Prishtinë